

Sic është njoftuar zyrtarisht partitë e opozitës do të organizojnë nesër një demonstratë kundër qeverisë së kryeministrit Berisha.

Deputetët e opozitës kanë dalë derë më derë për të shpërndarë trakte banorëve nëpër zona të ndryshme por për çudi kanë gjetur shumë pak njerëz nëpër lagje.



Arësyeja ishte se pjesa më e madhe e njerëzve falë liberalizimit të vizave kishin shkuar për pushime dhe ende nuk ishin kthyer nga Karaibet apo Peskara. Disa të tjerë ishin të tre punësuar. □ Edhe ata pak të moshuar që ndodheshin rrotull ishin të gjithë me laptopa e me tableta iSAL duke parë Facebook.

Me vështirësi deputetët socialistë kanë arritur tu futnin nëpër xhepa ndonjë trakt ndërsa të tjerëve ua vendosën trakte në xhamat e përparmë të makinave X5, shoferët e të cilave ishin kryesisht pensionistë dhe veteranë.

Ata u gëzuan pa masë në fillim por u pezmatuan kur panë se ishin ftesa për demonstratë.

“Menduam se është hapur ndonjë pub i ri pa për demonstrata s’na bie në mend” tha një pensionist duke xhiruar gomat e një Ferrari.

